Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 352/18
Datë/Datum. 17.08.2018
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 352/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "INTERLAB" shpk – Shtime, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE: NTP "ERAMED" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pajisje laboratorike e Teknologjisë Ushqimore", me numër të prokurimit: 97900/18/2146/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" – Mitrovicë më datë: 10.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "INTERLAB" shpk – Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pajisje laboratorike e Teknologjisë Ushqimore", me numër të prokurimit: 97900/18/2146/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" – Mitrovicë.

II. **ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës me titull: "Pajisje laboratorike e Teknologjisë Ushqimore", me numër të prokurimit: 97900/18/2146/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" – Mitrovicë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "INTERLAB" shpk – Shtime, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 16.04.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 07.05.2018, ku kanë marrë pjesë tre (3) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: "INTERLAB" shpk – Shtime, tenderues i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 05.07.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatoret ekonomik: "INTERLAB" shpk – Shtime, me dt: 09.07.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 11.07.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: "INTERLAB" shpk – Shtime, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: "INTERLAB" shpk – Shtime, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 16 Korrik 2018, me nr. 352/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: "Pajisje laboratorike e Teknologjisë Ushqimore", me numër të prokurimit: 97900/18/2146/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" – Mitrovicë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 41, 59, 105, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe Vendimin e OSHP-së te dt. 26.06.2018, me nr. 224/18.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.07.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 01.08.2018, sqaron:

Lidhur me pretendimin ankimor te OE-së ankuese se AK, ka shkelur dispozitat e Neneve: 1, 7, 59 dhe 105 te LPP-së, si dhe vendimin e OSHP-së te lëshuar me date 26.06.2018 me nr.224/18, qe kanë të bëjnë me rishpallen fitues te këtij aktiviteti te prokurimit ofertën e OE-së NTP "Eramed" e cila nuk i përmbush specifikimet minimale te detyrueshme respektivisht artikullin nr 2, ku kërkesë e AK-se ka qenë: Incubator Shaker INNOVA 44 M1282-0002 2.5 cm (1 in) Orbit, 230 V 50 Hz Temperature range 5 °C above ambient to 65 °C, ndërsa kompania e rekomanduar për kontrate NTP "Eramed" ka ofertuar me pajisje prej 5-60° C, eksperti shqyrtues, konstaton se duke u bazuar në dokumentacionin që posedon këto pretendime ankimore janë pjesërisht të bazuara, sepse pretendimet e njëjta janë trajtuar edhe me ankesën respektivisht Vendimin e OSHP-së nr.224/18 te datës 26.06.2018 me te cilin është konstatuar fakti se OE NTP "Eramed" ka ofruar pajisje me specifika për artikullin nr.2 prej 5-60° C te cilat specifika nuk janë konform kërkesave te parashtruar nga AK në dosjen e tenderit siç janë te përshkruara me lartë, mirëpo AK respektivisht komisioni i rivlerësimit duke e arsyetuar se specifikat e pajisjes se ofruar nga OE NTP "Eramed" nuk përbëjnë asnjë pengës lidhur me punën në laborator ne te cilën ka me u pendor padisja ka rekomanduar qe përsëri te rishpallet fitues OE i njëjtë. Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se oferta e OE te shpallur fitues nga AK ka vlerë financiare prej 23,694.25 € me lirë ne krahasim me ofertën e OE-së ankuese, mirëpo duhet të merret parasysh se bazuar në paragrafin 1.1 te nenit 60 te LPP-së ku thuhet se "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar "tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët" andaj për te shpallur fitues oferta e një operatori ekonomik duhet paraprakisht të vërtetohet se në rastin konkret a ka oferta te përgjegjshme te cilitdo pjesëmarrës konform kërkesave dhe dëshmive te parashtruara nga AK ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, në mënyrë që të kualifikohet dhe shpërblehet me kontratë. Përgjigje në Pretendimin nr.2 Lidhur me pretendimin ankimor te OE-së ankuese se AK, ka shkelur dispozitat e Nenit 41 te LPP-së eksperti shqyrtues, konstaton se duke u bazuar në dokumentacionin që posedon ky pretendim i OE ankues nuk qëndron sepse nuk ka ofruar ndonjë fakt ose element qe ndërlidhet me shkeljen e kësaj dispozite e cila flet për Njoftim për dhënien e kontratës.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura si dhe vendimin e OSHP-së me nr. 224/18 të datës 26.06.2018, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankuese:"Interlab" SHPK-Davidovc-Shtime të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandoj që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues – Universiteti i Mitrovicës, me datë: 03.08.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: "INTERLAB" shpk – Shtime, me datë: 05.08.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 10.08.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Sadriu deklaroj: Kërkesat e AK te specifikat teknike kanë qenë shumë të qarta. Specifikat janë bazuar në instumentitn Inova 44 dhe janë vetëm modele në botë që plotësojnë këto specifika te kërkuara. Kjo është një ndër arsyet pse ne kemi ofertën më të shtrenjtë se OE i rekomanduar për kontratë. kërkesa në dosje të tenderit ka qenë 5 deri 65 gradë celsius, ku ne kemi ofruar prej 5 deri 80 gradë celsius me mundësi caktimit të temperaturës. Ndërsa OE "Eramed" ka ofruar me 5 deri 60 gradë celsius, do thotë nuk përmbushë kërkesën e AK. Po te lejohej që të ofertojmë me devijime nga specifikat teknike atëherë edhe ne do të mund të ofertonim me një çmim më të lirë. Devijimi nga specifikat teknike të OE fitues nuk është devijim i vogël sepse ai dallim në temperaturë e bënë të pamundur trajtimin shumë baktereve për shkak të mungesës së temperaturës adekuate. Ne qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendime ankimore dhe i propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe AK ti përmbahet kërkesave të veta të dhëna në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim, lidhur me pretendimin ankimor te operatorit ekonomik ankuese se autoriteti kontraktues , ka shkelur dispozitat e Neneve: 1, 7, 59 dhe 105 te LPP-së, si dhe vendimin e OSHP-së te lëshuar me date 26.06.2018 me nr.224/18, qe kanë të bëjnë me rishpallen fitues te këtij aktiviteti te prokurimit ofertën e OE-së NTP "Eramed" e cila nuk i përmbush specifikimet minimale te detyrueshme respektivisht artikullin nr 2, ku kërkesë e AK-se ka qenë: Incubator Shaker INNOVA 44 M1282-0002 2.5 cm (1 in) Orbit, 230 V 50 Hz Temperature range 5 °C above ambient to 65 °C, ndërsa kompania e rekomanduar për kontrate NTP "Eramed" ka ofertuar me pajisje prej 5-60° C, paneli shqyrtues konstaton seautoritei kontraktues me rastin e rivlerësimit dhe rekomandimit për dhënie te kontratës te operatorit ekonomik NTP "Eramed" , ka vepruar ne kundërshtim me nenin 28 te LPP-së, për faktin se ka rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin e ekonomik i cili nuk i ka plotësuar specifikacionet teknike te detyrueshme te hartuara nga ana e autoriteti kontraktues.

Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe ne konstatimet e ekspertit shqyrtues konstaton se OE NTP "Eramed" ka ofruar pajisje me specifika për artikullin nr.2 prej 5-60° C te cilat specifika nuk janë konform kërkesave te parashtruar nga ana e autoritetit kontraktues e që kërkesa e autoritetit kontraktues ka qenë: Incubator Shaker INNOVA 44 M1282-0002 2.5 cm (1 in) Orbit, 230 V 50 Hz Temperature range 5 °C above ambient to 65 °C, ndërsa kompania e rekomanduar për kontrate NTP "Eramed" ka ofertuar me pajisje prej 5-60° C. Andaj paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në konstatimet e ekspertit shqyrtues si dhe deklarimet dhe sqarimet e palëve në procedurë, konstaton se devijimi nga specifikat teknike të OE fitues nuk është i lejuar sepse ai dallim në temperaturë e bënë të pamundur trajtimin shumë baktereve për shkak të mungesës së temperaturës adekuate .

Paneli shqyrtues se i përket pretendimit ankimor te OE-së ankuese se AK, ka shkelur dispozitat e Nenit 41 të LPP-së - Njoftim mbi dhënien e kontratës, konstaton se duke u bazuar në dokumentacionin që posedojmë ky pretendim i ankuesit nuk qëndron sepse operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar ndonjë fakt ose element qe ndërlidhet me shkeljen e kësaj dispozite, e qe neni 41 i LPP-së flet për - Njoftim për dhënien e kontratës.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" – Mitrovicë

1x1 OE - "INTERLAB" shpk – Shtime

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.